



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E FINANCEVE  
DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI I AKCIZES**

**UDHEZIM**

Nr. 08, date 09.11.2012

**"Mbi procedurat e mbikqyrjes se transportit dhe perdorimit te produkteve energjitike te perjashtuara nga akciza, per nevojat e veta, nga Operoret Ekonomike te kerkimit te naftes dhe te venies ne shfrytezim e zonave nafternbajtese"**

Me qellim administrimin dhe mbikqytjen korrekte te transportit dhe perdorimit te produkteve energjitike te perjashtuara nga akciza, per nevojat e veta, nga Operoret Ekonomike te kerkimit te naftes dhe te venies ne shfrytezim te zonave nafternbajtese;

Mbeshtetur ne nenin 10, pika 3, germa dh) e ne vijim te ligjit Nr. 61/2012, "Per akcizat ne Republiken e Shqiperise", nenit 21 e ne vijim te VKM nr. 612, date 5.9.2012 "Per dispozitat zbatuese te ligjit "Per akcizat", Drejtori i Pergjithshem i Doganave;

**UDHEZON:**

1. Zyra Doganore, ne te cilen kryhen procedurat e importit (niseses) te produkteve energjitike me perjashtim nga akciza per Operoret Ekonomike te kerkimit te naftes dhe te venies ne shfrytezim te zonave nafternbajtese, informon ne rruge elektronike (e-mail zyrtar) Zyren Doganore mbikeqyrese (pritese) te Operatorit Ekonomik perfitues, lidhur me sasine e produkteve te perjashtuara nga akciza qe kane kryer procedurat doganore dhe qe do te nisen drejt ketij Operatori. Ky informacion duhet te permbaje:

- a) Emrin dhe NIPT-in e Operatorit Ekonomik perfitues;
- b) Kodin e Zyres Doganore te importit;
- c) Kodin e magazines se lire nga ka dale produkti;
- d) Llojin e produktit;
- e) Kodin NK te produktit;

- f) Sasine e produktit;
- g) Numrin e deklarates se thjeshtuar (ose DAV-it kur nuk eshte perdorur deklarate e thjeshtuar;
- h) Targen e mjetit transportues;
- i) Sasine dhe numrat perkates te plumbve te vendosura ne mjetin e transportit;
- j) Data dhe ora e nisjes.

2. Zyra Doganore pritesë pas marrjes se-informacionit, merr masa qe te asistojë ne pritjen e te gjitha mjeteve te transportit te nisura drejt tyre.

3. Ne zbatim te Udhhezimit nr.16, date 3.5.2010, "Per administrimin dhe dokumentimin e procedurave te pajisjeve fiskale" te Ministrit te Financave, si dhe Udhhezimit nr. 5 dt.30.12.2011, "Per zbatimin praktik te procedurave qe ndiqen per hyrje daljen e mallrave ne magazinat e lira dhe mbikqyrjen e tyre" te Drejtorit te Pergjithshem te Doganave cdo autobot qe mberrin ne destinacion duhet te jete i shoqeruar me:

- a. deklaraten e thjeshtuar;
- b. libezen e mjetit (pasaporta e autobotit);
- c. faturen e shoqerimit te mallit (kuponi zevendesues tatimor);
- d. procesverbalin e plumbosjes se autobotit/eve (n.q.s nisen se bashku disa mjete).

4. Doganieret qe presin mjetet e transportit kryejne veprimet, sipas procedures qe vijon:

- a. Terheqin dokumentat e percaktuara ne piken 3 per vdo mjet, kryejne verifikimin e regjistrimit te mjeteve nga Operatori Ekonomik ne regjistrin e posavem (sipas Aneksit 1, bashkelidhur) dhe nese konstatojne mosregjistrim, garantojne dhe mbikqyrin regjistrimin e tyre. Ne kete regjister regjistrohen te dhenat per per cdo mjet referuar deklaratave te thjeshtuara perkatese, ndersa mbeshtetur ne deklaraten permbledhese IM4, behet DSHA-ja per hyrjen e mallrave ne magazinën fiskale;
- b. Verifikojne mjetet, duke bere krahasimin me informacionin e derguar nga Zyra Doganore nisesë.
- c. Nese konstatohet mosperputhje midis shenjave identifikuese (plumbve ose targa), ndalohe procedura e shkarkimit menjehere, bllokohet mjeti dhe mbahet proves-verbali perkates per shkeljen e konstatuar.
- d. Ne qofte se cdo gje perputhet vazhdohe me proceduren.

5. Bazuar ne analizen e riskut, per ngarkesa te caktuara, Zyra Doganore pritesë, mbikqyr proceduren e shkarkimit te produktit dhe verifikon rezultatin e peshimit te mjetit para dhe pas shkarkimit, duke bere krahasimet me libezen e mjetit dhe me peshen e deklaruar. Ne qofte se konstatohet mosperputhje, per shkeljen e konstatuar mbahet proves-verbali perkates. Nese ne ambientet e Operatorit Ekonomik nuk ka peshore, atehere peshimi ne keto raste duhet te kryhet ne peshoren e Zyres Doganore pritesë.

6. Zyra Doganore mbikqyrese, kryen kontrole periodike dhe/ose mbi bazen e analizes se riskut, per te matur gjendjen e produktit para ose pas shkarkimit te autoboteve ne depozitat perkatese, duke e krahasuar me gjendjen fizike te evidentuar ne librat perkates (hyrjet ne magazine, daljet, gjendjen e stokut te pasqyruar, si dhe duke analizuar evidencen e shperndarjes se produktit energjitik te perjashtuar nga akciza ne perputhje me karten teknologjike sipas planit te shperndarjes qe ka subjekti). Ne keto raste doganieri i caktuar ose grupi i punes mban procesverbalin perkates ne varesi te procedures se kryer (matje e gjendjes para dhe pas shkarkimit, administrim dokumentash, verifikim plumbcesh, marje mostrash apo kontroll i plote qe munda t'i perfshije te gjitha procedurat e mesiperme).

7. Brenda dates 10 te cdo muaji , zyra doganore mbikqyrese e magazines fiskale, ben rakordimet me operatorin ekonomik, lidhur me sasine e qarkulluar (formulari i mbajtjes se stokut, aneksin14 i VKM 612 dt.05.09.2012 ), per naften bruto, si dhe administron evidencen e shperndarjes se produktit energjitik te perjashtuar nga akciza, duke analizuar dhe kartat teknologjike. Nese do te jete e nevojshme, kjo evidence do te shoqerohet me analizen e kartes teknologjike, hartuar nga personat pergjegjes te operatorit ekonomik (ing. e kompanise).

8. Ngarkohen Deget Doganore dhe Departamenti i Akcizes per zbatimin e ketij Udhezimi.

Ky udhezim hyn ne fuqi menjehere.

**Flamur GJYMISHKA**  
**DREJTOR I PERGJITHSHEM**

### **ANEKSI 1. REGJISTRI I POSACEM PER REGJISTRIMIN E MJETEVE TE MBERRITURA**

Kodi i Magazinen Fiskale:

Data:

Kodi i NK i produktit:

Nr.	Targa e mjetit	Nr. i deklarates e thjeshtuar	Pershkrimi i mallit	Pasha (Ne kg)	Volumi (ne litra)
1.					
2.					
3.					
4.					
TOTALI		DAV:R	, date		